



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.748/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtar Hajriz Hoti, e me procesmbajtës Naim Shala, në konfliktin administrativ të paditëses Komuna e Glllogocit, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës së interesuar dhe të autorizuarit të tij, e në mungesë të palës paditëse dhe të paditur, me dt.10.01.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet kërkesëpadia e paditëses Komuna e Glllogocit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës, Agjencisë Kadastrale të Kosovës, nr.03/265/13, i dt.25.03.2015, dhe kthimin e çështjes në rishqyrtim dhe rivendosje, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prezencë të palës së interesuar, e në mungesë të palës paditëse dhe të paditur, të njoftuara në mënyrë të rregullt.

Paditësja, Komuna e Glllogocit, përmes padisë së ushtruar në këtë gjykatë me dt.27.04.2015, i ka propozuar gjykatës që të anulohet aktvendimi i të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, me nr.03/265/13, i dt.25.03.2015, si i kundërligjshëm dhe i pa bazuar, nga arsyet e dhëna në padi.

E paditura, Agjencia Kadastrale e Kosovës, përmes përgjigjes në padi të ushtruar me dt.26.04.2017, i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohen në tërësi si të pa bazuara, ndërsa aktvendimi i kontestuar me padi të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

I autorizuari i palës së interesuar, av.E.K, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e përkrahë në tërësi përgjigjen në padi të AKK-së, ashtu që gjykatës i propozon që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzon në tërësi si të pa bazuar, mbi bazën e përgjigjes në padi të paditurës. Konsideron se të gjitha pretendimet e palës janë të pa bazuara, sidomos kur thirret në nenin 84 dhe 86 të LPA, ngase në rastin konkret e paditura me të drejtë ka vendosur në pajtim me ligjin dhe arsyetimet e dhëna. Po ashtu, pretendimet e palës paditëse se, palës së paditur kinse i ka munguar kompetenca lëndore, nuk qëndrojnë, ngase e paditura ka vendosë si organ i shkallës së dytë në pajtim me nenin 36 të LPA, meqë paditësja e kishte refuzuar kërkesën e palës së interesuar në këtë çështje juridike, për regjistrimin e pronës në librat kadastralë, sipas Ligjit mbi Kadastrin. Vlenë për të theksuar se edhe sot e kësaj dite, paditësja nuk e zbaton vendimin e të paditurës AKK-së. Sido që të jetë, deklaron se pala e interesuar në këtë çështje juridike do të vazhdojë procedurën e mëtutjeshme.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.10.01.2018, ka bërë administrimin e provave që gjenden në shkresë të lëndës dhe atë: aktvendimi i të paditurës i dt.25.03.2015, parashtrësja e palës së interesuar e dt.02.06.2015, përgjigja në padi e të paditurës e

dt.26.04.2017, parashtrësia e paditësës drejtuar AKK-së e dt.25.05.2013 së bashku me provat e bashkangjitura, kopja e planit e KK Glllogoc e dt.03.12.1988, fleta poseduese e dt.05.12.1988, aktvendimi i AKK-së i dt.28.01.2014, dt.16.05.2013, ankesa e paditësës drejtuar AKK-së dt.25.11.2013, aktvendimi i lëshuar nga KK Glllogoc i dt.06.12.1988, dt.07.11.2013, aktvendimi i nxjerrë nga Gjykata Komunale në Glllogoc i dt.31.12.2008, 19.02.2013, aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A.nr.103/2014 i dt.31.05.2004, kontrata mbi dhënien e tokës në shfrytëzim mes KK Glllogoc dhe M.L nga K, kontrata e dt.16.05.1999 e lidhur mes B. në Prishtinë dhe M.L nga K, si dhe aktvendimi i KK Glllogoc i dt.24.02.1997.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësës është e pa bazuar.

Me aktvendimin e të paditurës AKK-së, me nr.03/265/13, të dt.25.03.2015, të goditur me padi, është aprovuar si e bazuar kërkesa e parashtruar nga J.Q e dt.06.02.2015, si dhe është obliguar Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, KK Glllogoc, që të bëjë regjistrimin e pronës së paluajtshme në bazë të Kontratës mbi Dhënien e Tokës Ndërtimore në Shfrytëzim me nr.34, të dt.01.02.1988 dhe Aktvendimit me nr.07-353-156 të dt.21.03.1988 të lëshuar nga Komuna e Glllogocit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua Ligjit për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, nr.2002/5, nenit 3.2 të të njejtit, i cili përcakton se “Parashtruesi që kërkon regjistrimin e të Drejtave të Pronave së Paluajtshme, kërkesës duhet t’ia bashkangjes dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi, të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij Ligji.

Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të Ligjit, regjistrohen në bazë të: vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës, vendimit të organit administrativ shtetëror, kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent, vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga AKP, vendimit të komisionit për rindërtim të kadastrit, vendimit të komisionit për rregullimin e tokave dhe dokumenti tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

Gjithashtu, gjykata iu referua edhe Udhëzimit Administrativ nr.2004/3, nenit 5 të të njejtit i cili përcakton bazën ligjore për regjistrim. Regjistrimi i një të drejte mbi pronën e paluajtshme mund të bazohet në një dokument valid nga një organ kompetent gjyqësor apo administrativ, vendim përfundimtar nga gjykata kompetente dhe me një transaksion ligjor, që përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi.

Me aktvendimin e Komunës së Glllogocit me numër 07-353-156 të dt.21.03.1988, M.L, i është ndarë truall në shfrytëzim të përhershëm toka ndërtimore për ndërtimin e objektit banesor, e evidentuar si parcelë kadastrale nr.3, në vendin e quajtur “Tuba e Alisë”.

Pasi që aktvendimi i Komunës së Glllogocit, me nr.07-353-156, i dt.21.03.1988, është bërë i plotëfuqishëm, është bërë edhe regjistrimi në regjistrin kadastral të Komunës së Glllogocit, me ç’rast paditësja i’a ka lëshuar M.L, bashkëshortes së tani palës së interesuar në emër të saj fletën poseduese me dt.05.12.1988 dhe kopjen e planit të datës 03.12.1988, e cila fletë poseduese dhe kopje e planit, janë vërtetuar nga origjinali, nga organi kompetent i Komunës së Glllogocit.

Mbi këto arsye gjiykata, vlerësoi të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim edhe me provat e lartëpërmendura.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e paditëses të dhënë në padi, se pala ka humbur të drejtën e përparësisë së ndërtimit në këtë tokë ndërtimore, sepse sipas aktvendimit 07 nr.353-156 të dt.21.03.1988, palës i është dhënë leja për ndërtim dhe në afatin e paraparë prej 3 vitesh sipas këtij aktvendimi, pala e ka humbur të drejtën e përparësisë në ndërtim, në kuptim të nenit 20 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore. Të njëjtin pretendim gjykata e vlerësoi si të pa bazuar nga fakti se bashkëshortes së kërkuesit J.Q, me aktvendimin e lartëcituar të Komunës së Glllogocit, i është ndarë trualli në shfrytëzim të përhershëm për ndërtimin e objektit banesor dhe nga kjo bazë e njëjta nuk e ka humbur këtë të drejtë.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga organi i paditur, i cili drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka aprovuar ankesën e ushtruar nga J.Q dhe ka obliguar Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të KK Glllogoc, që të bëjë regjistrimin e pronës së paluajtshme në bazë të Kontratës mbi Dhënien e Tokës Ndërtimore në Shfrytëzim me nr.34 të dt.01.02.1988 dhe Aktvendimit me nr.07-353-156 të dt.21.03.1988 të lëshuar nga Komuna e Glllogocit. Mbi këto arsye, thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.748/2015, dt.10.01.2018

Procesmbajtës
Naim Shala

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.